

## Koha për nota

INFORMATA PËR KUJDESTARËT MBI NOTA NË KLASËN E 6-të



**Tani do të fillojmë të vlerësojmë me nota qysh në klasën e 6-të. Notat janë një mënyrë për të treguar se si i shkon shkolla fëmijut tuaj. Nga kjo broshurë ju do të mësoni më shumë për vlerësimin me nota.**

Prej gjysmëvjetorit vjeshtor të vitit 2012 do të jepen dëftesa gjysmëvjetori për nxënës të klasave të 6-ta të shkollave fillore. Dëftesat e gjysmëvjetorit janë një lloj vlerësimi i njohurive që fëmijë juaj ka treguar deri në kohën për dhënjen e notës. Për gjuhë të zgjedhura (për shembull frëngjisht, gjermanisht, spanisht) fëmijë merr notë prej klasës së 7.

Dëftesa gjysmëvjetori ipen për klasët 6 – 9. Notën e fundit fëmijë juaj e merr në klasën e 9 dhe kjo është notë përfundimtare. Me këtë notë fëmijët paraqesin kërkesën për pranim në gjimnaz.



## Informimi i qartë zvogëlon rrezikun për keqkuptime

Të gjithë nxënësit duhet të informohen mbi objektivat dhe kërkesat për njohuri sapo mësimi në lëndët shkollore të fillojë. Mësuesi do të informojë se si shkojnë punët me fëmijun tuaj në shkollë dhe mbi cilat baza do të ipen notat.

Notat janë një mjet për të treguar se si njohuritë e fëmijut tuaj i përgjegjen kërkesave për njohuri. Notat gjithashtu mund të tregojnë nëse fëmiju juaj ka nevojë për ndihmë për të realizuar kërkesat e njohurive për notën më të ulët kaluese. Bisedat zhvillimore dhe plani individual zhvillimor do t'u ofrojnë informata mbi atë se si shkojnë punët me fëmijun tuaj në shkollë.

Ju dhe fëmiju juaj keni poashtu të drejtë që prej mësuesit që ka marrë vendimin për notën të informoheni mbi arsyet e notës në lëndët mësimore.



## Notat

Në shkollën fillore notat janë gjashtësh-kallëshe: A, B, C, D, E dhe F. A është nota më e lartë ndërsa E është nota më e ulët kaluese. F është notë jokaluese. Të gjitha këto nota do të zbatohen. Fëmiju juaj prandaj ka mundësi që të marrë notën A qysh në klasën e 6-të.

Nëse nuk mundemi të japim notë për shkak se fëmiju juaj ka munguar një kohë të gjatë në shkollë atëherë këtë do ta shënjojmë me një vizë.

## Mungesat

Ju si kujdestar mbani përgjegjësinë kryesore që fëmiju juaj të vie në shkollë rregullisht. Nëse fëmiju juaj mungon pa leje të mësuesit ose rektorit atëherë ai do të marrë mungesë të paarsyeshme. Kur fëmiju juaj mungon pa arsye ju si kujdestar keni të drejtë të merrni vesh për këtë po atë ditë që ai mungon. Mungesat e paarsyeshme do të shënohen në dëftesën e gjysmëvjetorit.





## Provimet nacionale

Fëmiu juaj i është nënshtruar provimeve nacionale qysh në klasën e 3-të. Në klasën e 6-të do të mbahen provime nacionale për gjuhën angleze, matematikë, suedisht ose suedisht si gjuhë joamtare, një lëndë orientimi shoqëror dhe një të orientimit natyror. Lëndë orientimi shoqëror janë gjeografia, historia, njohuri mbi religjione dhe njohuri mbi shoqërinë. Lëndë orientimi natyror janë biologjia, fizika dhe kimia.

Provimet nacionale ndihmojnë mësuesin të vlerësojë njohuritë e fëmiut tuaj dhe do të jenë një ndihmesë për mësuesin që të vë notë.

## Notat në shkollën fillore speciale

Në shkollën fillore speciale fillore japim nota vetëm nëse ju ose fëmiu juaj dëshironi. Kjo nuk vlen për shkollat trajnuese, në to nuk ipen nota. Notat janë pesëshkallëshe: A, B, C, D dhe E. Nëse fëmiu nuk arrin të përmbush kërkesat për notën E atëherë nuk do të ipet fare notë.

Vizat nuk do të përdoren në shkollën speciale fillore. Mirëpo mungesat e paarsyeshme do të figurojnë në dëftesën e gjysmëvjetorit. Në shkollën fillore speciale nuk mbahen provime nacionale.



## Doni të dini më shumë mbi notat?

Lexoni më shumë në [www.skolverket.se/betyg](http://www.skolverket.se/betyg)

ISBN: 978-xx-xxxx-xx-x  
Grafisk form: AB Typoform  
Illustrationer: Karl Lindahl  
Skolverket 2012

*Skolverket*